

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

NDËRTIMI I AUTOSTRADAVE DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR PËRMES PRIZMIT TË BE-SË


TOGETHER IN
**CLIMATE
ACTION**

NDËRTIMI I AUTOSTRADAVE DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR PËRMES PRIZMIT TË BE-SË

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Autore

Bojana Bozhinovska Siljanovska

Redaktues

Bojan Trpevski

Projekti

Organizatata civile në veprim për ndryshimet klimatike

Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

Redaktimi gjuhësor

Eleonora Stojkoska –Popetrevska

Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi

Rexhep Xheladini

Dizajn grafik

Haris Muriq

Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Organizatata civile në veprim për klimën", mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

PËRMBLEDHJE	1
HYRJE	2
METODOLOGJIA	3
NDËRTIMI I KORRIDOREVE 8 DHE 10-D ME PARTNERIN STRATEGJIK, KONSORCIUMIN "BEHTEL DHE ENKA"	4
MBROJTJA E PYJEVE NË BE	5
ÇËSHTJA PYLLIT BJALOVIEZHA/BIAŁOWIEŻA (KOMISIONI KUNDËR POLONISË)	6
VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR	7
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	10
LITERATURA E PËRDORUR	11

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE

Evropa është një nga rajonet pyjore më të pasura në botë (45% e tokës së Evropës është e mbuluar nga pyje). Megjithatë, praktikat aktuale të menaxhimit të pyjeve nuk janë gjithmonë në përputhje me nevojën për të siguruar biodiversitetin të lartë në ekosistemet pyjore. Me kërkesën gjithnjë në rritje për lëndë drusore, pyjet dhe ekosistemet e tyre vazhdojnë të vuajnë nga ndotja e ajrit dhe ujit, humbja e habitatit dhe biodiversitetit dhe cenimi i zonave urbane.

Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor synon të parashikojë ndikimet e mundshme të dëmshme në mjedisin jetësor dhe të shmangë ose reduktojë ndikime të tilla të dëmshme, duke balancuar objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Legjislacioni i Maqedonisë parasheh procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor dhe projekte që duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedis jetësor që është i sinkronizuar me Direktivën e Bashkimit Evropian (BE). Ndërtimi i autostradave është i përfshirë në projekte ku kërkohet vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor i detyrueshëm sipas rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së) dhe BE-së.

Më 7 mars 2023, qeveria RMV-së miratoi marrëveshjen për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d, të cilat duhet të ndërtohen nga konsorciumi amerikano-turk "Behtel dhe Enka". Në prill të vitit 2023, në Kuvend është dorëzuar Propozimi për Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Pyjet.¹

Ekziston praktika e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së ku shtetet anëtare detyrohen të paguajnë gjopa enorme prej 100.000 euro në ditë për shkak të prerjeve të paligjshme dhe shkatërrimit të pyjeve.

Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë ligjet dhe rregulloret e tjera dhe nuk duhet të lejojë ndryshimin e tyre të nënkuptojë një ndikim të përhershëm të dëmshëm në mjedisin jetësor.

Ndërtimi i shpejtë i autostradave dhe ndryshimi i rregulloreve nuk duhet të nënkuptojnë dëmtim të shpejtë të biodiversitetit.

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 55, përcakton se Liria e tregut dhe e sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë ligjet dhe rregulloret e tjera dhe nuk duhet të lejojë ndryshimin e tyre të nënkuptojë një ndikim të përhershëm të dëmshëm në mjedisin jetësor.

Ndërtimi i shpejtë i autostradave dhe ndryshimi i rregulloreve nuk duhet të nënkuptojnë dëmtim të shpejtë të biodiversitetit.

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 55, përcakton se Liria e tregut dhe e sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

¹ Propozim Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Pyjet, me procedure të shkurtuar, <https://sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=50cbfac1-3398-41da-9659-cedb7fc5db9b>

HYRJE

Pyjet janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien tonë, si dhe për shëndetin e planetit. Ata kanë biodiversitet të pasur (80% e biodiversitetit ka shtëpi në zonat pyjore) dhe kanë një rëndësi të madhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ata na ofrojnë ujë të pastër, ushqim, ilaçe dhe materiale (25% e njerëzve varen nga pyjet për jetesën dhe të ardhurat), zvogëlojnë rrezikun e fatkeqësive dhe stabilizojnë tokën.

Evropa është një nga rajonet pyjore më të pasura në botë (45% e tokës së Evropës është e mbuluar nga pyje). Megjithatë, praktikat aktuale të menaxhimit të pyjeve nuk janë gjithmonë në përputhje me nevojën për të siguruar biodiversitet të lartë në ekosistemet pyjore. Me kërkesën gjithnjë në rritje për lëndë drusore, pyjet dhe ekosistemet e tyre vazhdojnë të vuajnë nga ndotja e ajrit dhe ujit, humbja e habitatit dhe biodiversitetit dhe cenimi i zonave urbane.²

Kushtet natyrore në RMV-së të përcaktuara nga vendndodhja, klima, relievi, struktura pedologo-gjeologjike e terrenit, karakteristikat hidrologjike-hidrografike e të tjera, mundësojnë mbijetesën dhe zhvillimin e një numri të madh të llojeve bimore dhe shtazore. Prandaj, vendi ynë llogaritet ndër vendet me biodiversitet të pasur. Një numër i madh i specieve bimore dhe shtazore janë relikte dhe endemike.

Bazuar në funksionet e shumta publike të pyjeve, RMV-së i sheh pyjet si pjesë të pasurisë kombëtare, pra trashëgimisë. Këtë e vërteton edhe Kushtetuta e RMV-së, ku "të gjitha thesaret natyrore të Republikës, jeta bimore dhe shtazore, të mirat e përdorimit të përgjithshëm, si dhe objektet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj janë mallra me interes të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë".

² https://environment.ec.europa.eu/topics/forests_en#:~:text=They%20are%20rich%20in%20biodiversity,rich%20regions%20in%20the%20world

³ <http://mkdsumi.com.mk/zasumite.php?page=3&s=>

METODOLOGJIA

Punimi synon të arrijë objektivat e mëposhtme kërkimore:

- **Analizimi i situatës me ndërtimin e autostradave në korridoret 8 dhe 10d nga këndvështrimi i së drejtës për mjedis jetësor të shëndetshëm;**
- **Identifikimi dhe vënia në dukje e standardeve të së Drejtës së BE-së dhe praktikës së Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, si dhe akteve të tjera ndërkombëtare dhe vendore;**
- **Dhënia e rekomandimeve;**
- **Zbatimi i politikës që ndërtimi i shpejtë i autostradave të mos ketë ndikim të dëmshëm në mjedisin jetësor.**

Qasja metodologjike në përgatitjen e dokumentit përfshin zbatimin e metodave të mëposhtme të kërkimit:

- **Hulumtim nga zyra – konsultim të së drejtës përkatëse, raporteve dhe dokumenteve.**

NDËRTIMI I KORRIDOREVE 8 DHE 10-D ME PARTNERIN STRATEGJIK, KONSORCIUMIN "BEHTEL DHE ENKA"

Më 7 mars 2023, Qeveria e RMV-së e miratoi marrëveshjen për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d, të cilat duhet të ndërtohen nga konsorciumi amerikano-turk "Behtel dhe Enka".

Ofensivë e fortë ndërtimore, ndërtimi i një rrjeti rrugor bashkëkohor, cilësor dhe të sigurt, paralajmëron Qeveria pas nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d me partnerin strategjik, konsorciumin "Behtel dhe Enka". Pas pesë vitesh pritet të shihen efektet e para të projektit, i cili mbulon katër seksione autostrade. Plani është që deri atëherë të përfundojë ndërtimi i Korridorit 8, i cili do të shtrihet në gjatësi prej 68 kilometrash me autostradë me 6 korsi dhe do të lidhë Tetovën me Gostivarin, Kërçovën, Strugën deri në Qafëthanë. Në Korridorin 10-d do të ndërtohet autostrada me 6 korsi në gjatësi prej 40 kilometrash, e cila do të lidhë Prilepin me Manastirin.⁴

Më 10 prill, deputetët në Kuvendin e Maqedonisë votuan për nevojën për ndryshimin e tetë ligjeve që kanë të bëjnë me ndërtimin e autostradave, përfshirë Ligjin për Pyjet.

Me ndryshimet e propozuara shtohet neni i ri 14b i cili përcakton se: Për ndërtesat me interes strategjik të rregulluara me ligj nuk zbatohen dispozitat ligjore dhe konvertimi i pyllit dhe tokës pyjore do të konsiderohet i përfunduar dhe i përshtatshëm për hyrje në kadastrën e patundshmërive pa pasur nevojë që investitori të kryejë procedura të mëtejshme ose të marrë ndonjë pëlqim, miratim ose ndonjë vendim ose dokument tjetër nga ndonjë autoritet.

Duke dashur të shkurtojë burokracinë, ligjvënësi mund të vërë në dyshim sundimin e ligjit. Gjithashtu, ky ndryshim i papritur ligjesh dhe shkurtrimi rrënjësor i procedurave të përcaktuara me ligj, vë në pikëpyetje respektimin e akteve të tjera rregullative dhe nën-ligjore si dhe akteve të Qeverisë në fushën e mjedisit jetësor, të cilat nga ana tjetër mund të ndikojnë në sigurinë juridike.

⁴ <https://www.dw.com/mk/avtopati-asfaltirani-so-somnez-behtel-i-enka-ke-gradat-cetiri-avtopati-za-13-milijardi-evra/a-64918158>

MBROJTJA E PYJEVE NË BE

BE-ja ndan disa kompetenca të lidhura me pyjet me shtetet anëtare, duke përfshirë mjedisin jetësor, klimën dhe bujqësinë. Gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave, Bashkimi Evropian respekton parimin e subsidiaritit. Në veçanti, mbrojtja e pyjeve është një pjesë thelbësore e aktiviteteve të mjedisit jetësor të BE-së dhe kompetencës së BE-së bazuar në nenet 191-192 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së, siç konfirmohet nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Strategjia e BE-së për Pyjet 2030 është një nga nismat kryesore të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Strategjia përcakton një vizion dhe veprime konkrete për të përmirësuar sasinë dhe cilësinë e pyjeve të BE-së dhe për të forcuar mbrojtjen, restaurimin dhe rezistencës/elasticitetin e tyre. Ajo synon të përshtatë pyjet evropiane me kushtet e reja, ekstremet e motit dhe pasigurinë e lartë të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.⁵

Siç thuhet në Strategjinë e BE-së për Pyjet 2030, BE-ja synon të:

- mbrojtje pyjet dhe vlerën e shumë shërbimeve të ekosistemit që ato ofrojnë;
- mbjell të paktën 3 miliardë pemë shtesë në BE;
- kontribuoj për një ekonomi moderne, neutrale ndaj klimës, burimeve efikase dhe konkurruese;
- ruaj zonat e gjalla rurale dhe të ndihmojë në ruajtjen e një popullsie rurale të begatë;
- sigurojë që produktet që konsumohen në BE të mos kontribuojnë në shpyllëzimin global.

BE-ja synon politikat specifike të mëposhtme:

Parandalimi i shpyllëzimit

Rregulla që sigurojnë që produktet që konsumohen në BE, të mos kontribuojnë në shpyllëzimin global.

Monitorimi i pyjeve

Sigurimi i disponueshmërisë së informacionit në kohë dhe të saktë mbi gjendjen dhe menaxhimin e pyjeve të BE-së.

Zjarret pyjore

- Parandalimi dhe monitorimi i zjarreve në pyjore dhe ofrimi i ndihmës kur ato goditen.⁶

⁵ https://environment.ec.europa.eu/topics/forests_en

⁶ Ibid

Mbrojtja e mjedisit është e kodifikuar në nenin 37 të Kartës së të Drejtave Themelore të Njeriut të Bashkimit Evropian dhe thotë: “Në politikat e Bashkimit, një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit natyror dhe përmirësimi i cilësisë së tij duhet të integrohet dhe sigurohet në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm”⁷. Me këtë nen, mbrojtja e mjedisit jetësor praktikisht fitoi rëndësi për të drejtat e njeriut në kontekstin ligjor të BE-së.⁸

ÇËSHTJA PYLLIT BJALOVIEZHA/BIAŁOWIEŻA (KOMISIONI KUNDËR POLONISË)

Pylli Bjaloviezha është vend i mbrojtur, vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe përfaqëson një nga pyjet e fundit primare në Evropë. Në mars 2016, autoritetet polake miratuan një vendim që lejon një rritje të trefishtë të operacioneve të prerjes së pyjeve në rrethin e saj, si dhe prerjet në zonat e përjashtuara më parë nga çdo ndërhyrje. Më vonë gjatë vitit, Komisioni Evropian nisi një hetim për prerjet në këtë pyll dhe në korrik 2017 vendosi ta referonte Poloninë në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE-së). Më 27 korrik 2017, u miratua një masë e përkohshme që urdhëronte vendin të ndërpresë menaxhimin aktiv të pyjeve. Më 20 shkurt 2018, Këshilli i Përgjithshëm i Gjykatës lëshoi një Mendim sipas të cilit vendimet e menaxhimit të pyjeve të marra nga Polonia në lidhje me këtë zonë shkelin ligjin e BE-së, pasi ato vendime mund të rezultojnë domosdoshmërisht në përkeqësimin e riprodhimit të specieve të mbrojtura. Më 17 prill, vendimi i Gjykatës së Drejtësisë konfirmon mendimin e mëparshëm, duke pretenduar se Polonia nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas disa direktivave.¹⁰

Autorizimi për një plan ose projekt, siç përmendet në nenin 6(3) të Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, i ndryshuar nga Direktiva 2013/17, mund të jepet vetëm me kusht që kompetenti autoritetet sigurojnë që plani ose projekti nuk do të ketë efekte negative të qëndrueshme në integritetin e vendit në fjalë. Është një rast kur nuk ka dyshim të arsyeshëm shkencor për mungesën e efekteve të tilla. Autoritetet kombëtare kompetente nuk mund të miratojnë ndërhyrjet kur ekziston rreziku i dëmtimit të përhershëm të veçorive ekologjike të vendeve që strehojnë lloje të habitateve natyrore me interes ose prioritet të Komunitetit. Kjo do të ishte veçanërisht e vërtetë kur ekziston rreziku që ndërhyrja të çojë në zhdukjen ose shkatërrimin e pjesëshëm dhe të pariparueshëm të një lloji të tillë habitati natyror në vendndodhjen e prekur.¹¹

⁷ https://ec.europa.eu/info/index_en

⁸ Членот 37 од Повелбата вели: „Во политиките на Унијата мора да биде интегрирано и осигурено високо ниво на заштита на природната средина и подобрување на нејзиниот квалитет во согласност со начелото за одржлив развој”. Povelba.indd (europa.eu)

⁹ <http://bitly.ws/Hik6> - Неисполнување на обврските на земјата-членка - Животна средина - Директива 92/43/EEЗ - Зачувување на природните живеалишта и дивата фауна и флора — член 6(1) и (3) — член 12(1) — Директива 2009/147/ЕЗ — Зачувување на дивите птици — членови 4 и 5 — „Puszcza Białowieńska” Локација Натура 2000 — Измена на план за стопанисување шуми — Зголемување на обемот на дрво што може да се жнее - План или проект што не е директно потребен за управувањето со локацијата што е веројатно да има значаен ефект врз него - Соодветна проценка на импликациите за локацијата - Негативно влијание врз интегритетот на локацијата - Реално спроведување на мерките за заштита - Ефекти врз местата за размножување и местата за одмор на заштитените видови.

¹⁰ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:62017CJ0441_SUM

Vendimi tregon se Komisioni i BE-së, në dritën e parimit të kujdesit, i cili është integruar në dispozitën në nenin 6(3) të Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, të ndryshuar me Direktivën 2013/17, "nuk duhet të provojë një lidhje shkakësore midis operacioneve në fjalë dhe efektit negativ në integritetin e habitateve dhe specieve, mjafton të vërtetohet ekzistenca e një probabiliteti ose rreziku që këto operacione mund të çojnë në një efekt të tillë".¹¹

Neni 6(1) i Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, i ndryshuar nga Direktiva 2013/17 dhe neni 4 (1) dhe (2) i Direktivës 2009/147 për ruajtjen e shpendëve të egra, i ndryshuar nga Direktiva 2013/17, kërkon që masat e ruajtjes të nevojshme për të mbajtur një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve dhe specieve të mbrojtura brenda zonës përkatëse jo vetëm të miratohen, por mbi të gjitha të zbatohen në të vërtetë.¹²

Në aktgjykim po ashtu theksohet se sipas nenit 12(1)(a) dhe (ç) të Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër dhe nenit 5 të Direktivës 2009/147 për ruajtjen e shpendëve të egër, të ndryshuar nga Direktiva 2013/17 jo vetëm që Shtetet Anëtare janë të detyruara të miratojnë legjislacionin gjithëpërfshirës dhe efektiv, por edhe ata janë të detyruar të marrin masa mbrojtëse. Në mënyrë të ngjashme, sistemi i mbrojtjes rreptë supozon miratimin e masave koherente dhe të koordinuara të një natyre parandaluese. Prandaj, një sistem i tillë i mbrojtjes së rreptë duhet të lejojë shmangien reale të kapjes ose vrasjes së qëllimshme në natyrë dhe përkeqësimin ose shkatërrimin e vendeve të shumimit ose të pushimit të specieve shtazore dhe shpendëve.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR

Kreu XI i Ligjit për Mjedisin Jetësor përcakton procedurën për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor. Një vlerësim i ndikimit të mjedisit jetësor synon të parashikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe të shmangë ose reduktojë ndikime të tilla negative, duke balancuar objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike. Gjatë kryerjes së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor, duhet të merren gjithmonë parasysh masat për të parandaluar, kufizuar, zbutur ose reduktuar ndikimet e dëmshme dhe duhet të jepet një vlerësim i efekteve të masave të propozuara. Dhe nuk është më pak e rëndësishme që gjithmonë të jetë e mundur të bëhet një propozim për vendndodhje të tjera alternative për ekzekutimin e projektit, në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i dëmshëm në mjedisin jetësor.¹³

¹¹ Ibid параграф 158

¹² Ibid параграфи 213, 214, 218

¹³ <https://www.moep.gov.mk/wp-content/uploads/2015/01/Brosura-Ocena-na-vlijaniето-vrz-zivotnata-sredina.pdf>

Direktiva e BE-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Jetësor synon të sigurojë që projektet që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor janë identifikuar dhe vlerësuar, si pjesë e procesit të vlerësimit, përpara se këto projekte të vazhdojnë me zhvillimin.

Ky vlerësim përfshin një përshkrim të projektit, duke përfshirë një vlerësim, sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura (ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, zhurma, dridhja, drita, nxehësia, rrezatimi, etj.) që rezultojnë nga zbatimi i projektit të propozuar. Projektet e renditura në Aneksin 1 të Direktivës vlerësohen se kanë ndikime të rëndësishme në mjedisin jetësor dhe për këtë arsye kërkohet t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit mjedisit jetësor. Aneksi 2 tregon projektet ku vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është zgjedhore.

Ndërtimi i autostradave dhe rrugëve të shpejta renditet gjithashtu në projektet që duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedisin jetësor të renditur në Aneksin 1 të kësaj Direktive.¹⁴

Në bazë të nenit 77 të Ligjit për Mjedisin Jetësor, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar Dekretin për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor¹⁵. Dekreti është i sinkronizuar me Direktivën e BE-së dhe i njëjti në Aneksin 1, pika 7(b) përfshin ndërtimin e autostradave si projekte për të cilat është i detyrueshëm vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor.

Përveç kësaj, Maqedonia e Veriut është nënshkruese e Konventës për qasje në informacion, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet e mjedisit jetësor të Kombeve të Bashkuara¹⁶. Neni 6 i Konventës flet për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e aktiviteteve specifike, ndër të cilat projektet për ndërtimin e autostradave renditen në aneksin 1. Neni 6, pika 6 tregon se sa vijon duhet të jetë në dispozicion të publikut: (a) Përshkrimi i vendit të zbatimit dhe veçorive fizike dhe teknike të aktivitetit të propozuar, si dhe një vlerësim i mbetjeve dhe emetimeve të pritshme; (b) Përshkrimi i ndikimeve të rëndësishme në mjedisin jetësor të aktivitetit të propozuar; (c) Përshkrimi i masave të parashikuara për të parandaluar dhe/ose reduktuar pasojat, duke përfshirë emetimet; (ç) Një përmbledhje jo-teknike e sa më sipër; (e) Një përmbledhje e alternativave parësore të studiuara nga kandidati. Sipas kësaj, jo vetëm zhvilluesi i projektit të ndërtimit të autostradës është i detyruar të paraqesë një raport të ndikimit në mjedisin jetësor, por edhe publiku duhet të njoftohet për të. Anëtari merr masa që publikut t'i jepet një përgjigje e duhur me shkrim dhe një bisedë me kandidatin dhe më tej në vendim duhet të merret parasysh rezultati i pjesëmarrjes së publikut dhe publiku duhet të informohet për vendimin.

¹⁴ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0092>

¹⁵ ЕУ-директива 2011/92, анекс 1 точка 7(б)

¹⁶ <http://bitly.ws/Hipj>

¹⁷ <https://unece.org/DAM/env/pp/documents/cep43mac.pdf>

Në grupin e propozimeve për ndryshime ligjesh nuk është përmendur asnjë ndryshim në Ligjin e Mjedisit Jetësor dhe as publiku nuk është njoftuar për ndryshim të Dekretit të Qeverisë. Por në të njëjtën kohë, publiku nuk është i informuar për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor. Nga inspektimi i ueb faqes së Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,¹⁷ deri më tani nuk është bërë e ditur synimi për realizimin e projektit, i cili është obligim sipas neneve 80 dhe 90 të Ligjit për Mjedisin Jetësor. Ndryshimi i Dekretit, i cili në thelb është në përputhje me ligjin e BE-së, do të çonte në pasiguri juridike, por edhe në dëme potenciale të pakthyeshme për natyrën dhe biodiversitetin.

Përveç kësaj, ky dokument i politikave publike specifikon nevojën për të praktikuar të drejtën e sinkronizuar me BE-në dhe respektimin e saj, përndryshe RMV-ja si një vend në negociata për kandidat në BE do të kishte një përgjegjësi indirekte.

Gjithashtu duhet përmendur se përveç rregullimeve juridike dhe aspektit juridik ndërkombëtar Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 55, përcakton se Liria e tregut dhe e sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

Megjithëse adresimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor ka përparësi ndaj veprimeve parandaluese, ka shembuj të praktikave të mira në përfshirjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore në projektet kapitale të RMV-së. Për ndërtimin e disa pjesëve të autostradës mes Shkupit dhe Kosovës, Vlerësimi ndaj ndikimit mjedisit jetësor dhe aspektet sociale (VNMJAS), dha sugjerime se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Masat e propozuara duhet të përfshihen në projektin kryesor, kështu që kontraktori do të duhet t'i zbatojë ato gjatë ndërtimit. Ky është një shembull tjetër i një praktike të tillë, përveç Studimit të VNMJAS-së për autostradën Bukojçan-Kërçovë, studimin e VNMJAS-së për rrugën shtetërore A3: seksioni Manastir-kalimi kufitar Mexhitlia, pastaj për rrugën shtetërore Strumicë-Valandovë: kryqëzimi me A1. Në transportin hekurudhor mund të përmendim Studimin e VNMJAS-së për ndërtimin e hekurudhës së re në seksionin Kriva Pallankë – Kufiri me Republikën e Bullgarisë, si pjesë e Korridorit 8. Në të gjitha këto studime, planifikuesve të projektit bazë u rekomandohet të përdorin udhëzimet e zhvilluara dhe nëse është e përshtatshme, të zbatojnë disa nga rekomandimet dhe masat për të reduktuar ndikimet negative në mjedis nga ndryshimet klimatike. Pra, tashmë ka praktikë pozitive në aplikimin e udhëzimeve për projektimin e infrastrukturës rezistente ndaj klimës, të hartuara për Ndërmarrjen Publike Rrugët Shtetërore.¹⁸

¹⁸ <http://bitly.ws/HipN>

¹⁹ Анализа на развојот и одржливото планирање на транспортот во РСМ од аспект на влијанието врз климатските промени, МЗМП2023

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- › Vlerësimi i ndikimeve ndaj natyrës gjatë ndërtimit të autostradave është i detyrueshëm dhe nuk duhet të lihet të bëhet vetëm për shkak të natyrës strategjike të zbatimit të projektit.
- › Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor gjatë ndërtimit të autostradave duhet të përmbajë propozime se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Ky nuk është vetëm një rregull i pranuar në vendet e zhvilluara, por është edhe një praktikë e ndërmarrë gjatë ndërtimit të disa prej autostradave tona. Një projekt i tillë i detajuar me një vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor, duke marrë parasysh ndryshimet klimatike duhet të jetë aty për çdo ndërtim autostradash.
- › Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë ligjet dhe rregulloret e tjera dhe nuk duhet të lejojë ndryshimin e tyre të nënkuptojë një ndikim të përhershëm të dëmshëm në mjedisin jetësor. Ndërtimi i shpejtë i autostradave dhe ndryshimi i rregulloreve nuk duhet të nënkuptojnë dëmtim të shpejtë të biodiversitetit.
- › Është e nevojshme të respektohet sundimi i ligjit dhe të sigurohet siguria juridike. Ndryshimi i dekretit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor që është i sinkronizuar me direktivën e BE-së do të nënkuptonte sjelljen e pasigurisë ligjore, por edhe dëme të pakthyeshme të mundshme për natyrën dhe biodiversitetin.
- › Gjatë sjelljes së ndryshimeve në Ligjin për Pyjet, organi legjislativ duhet të marrë parasysh Çështjen e Pyllit Bjaloviezha/Białowieża (Komisioni kundër Polonisë).
- › Publiku duhet të përfshihet në procesin e vendimmarrjes për ndërtimin e autostradës. Mungesa e një vlerësimi në dispozicion të ndikimit në mjedisin jetësor është në kundërshtim me Konventën e Aarhusit.
- › **Realizimi efektiv i projekteve strategjike nuk duhet të nënkuptojë efekt negativ në mjedisin jetësor dhe ekzistencën e pasigurisë ligjore. Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë dokumentet ndërkombëtare në të cilat është nënshkruese, si dhe të drejtën vendore, e cila është e sinkronizuar me BE-në, dhe në këtë mënyrë ka një përgjegjësi të nënkuptuar ndaj BE-së.**

LITERATURA E PËRDORUR

- › https://environment.ec.europa.eu/topics/forests_en#:~:text=They%20are%20rich%20in%20biodiversity,rich%20regions%20in%20the%20world
- › <http://mkdsumi.com.mk/zasumite.php?page=3&s=>
- › <https://www.dw.com/mk/avtopati-asfaltirani-so-somnez-beh-tel-i-enka-ke-gradat-cetiri-avtopati-za-13-milijardi-evra/a-64918158>
- › https://environment.ec.europa.eu/topics/forests_en
- › https://ec.europa.eu/info/index_en
- › Karta e BE-së
- › C-441/17, Комисија против Полска, 17 април 2018 година (Białowieża)
- › Извештај на ЕСП за пресудата за случајот C-441/17, Комисија против Полска
- › Оцена на влијанието на животната средина, Министерство за животна средина и просторно планирање
- › DIRECTIVE 2011/92/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 December 2011 on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment
- › <https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2014/09/Uredba%20za%20opredeluvanje%20na%20proektite%20i%20za%20kriteriumite%20vrz%20osnova%20na%20koi%20se%20utvrduva%20potrebata%20za%20postapkata%20za%20OVZS.pdf>
- › Конвенцијата за пристап до информации, учество во јавноста во одлучувањето и пристап до правда за прашањата поврзани со животната средина на Обединетите Нации
- › Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV-ë nga këndvështrimi i ndikimit në ndryshimet klimatike, SHJRM 2023

